



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.364/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.05.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizimi i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Sulollari” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Proçedurë e hapur”, me numër REF-24353-02-17-2016 me objekt *Loti III "Riparim-mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja; stacionit qëndror të pompave të ujit të pijshëm dhe elektropompave të godianve të shërbimeve spitalore"*”, me fond limit 2.298.375 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 11.03.2016, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nëne Tereza”, Tiranë.

Ankimues:

“Sulollari” sh.p.k
Rruga “Muhamet Gjollesha”, 71/3 Kati.1.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nëne Tereza”,
Tiranë.
Rruga e Dibrës Nr.372, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.02.2016, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me numër REF-24353-02-17-2016 me objekt *Loti III “Riparim-mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja; stacionit qendror të pompave të ujit të pijshëm dhe elektropompave të godinave të shërbimeve spitalore”*, me fond limit 2.298.375 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 11.03.2016, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nëne Tereza”, Tiranë.

II.2. Në datën 11.03.2016, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 31.03.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Sulollari	1,578,000.00	I skualifikuar
- Comfort	1,629,260.00	I skualifikuar

II.4. Operatori ekonomik “Sulollari” sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet e mëposhtme:

- “Nuk plotëson pikën a) të kapacitetit teknik: Shërbime të ngjashme (Riparim-mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja; stacionit qendror të pompave të ujit të pijshëm dhe elektropompave të godianve të shërbimeve spitalore) në një vlerë prej 40 % e vlerës së fondit limit të lotit 3 të realizuara gjatë tre viteve të fundit (2013, 2014, 2015) të aktivitetit të operatorit ekonomik.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k dhe “Ershen” shpk lidhur me pikën ç) të kapacitetit teknik “ ç) Operatori ekonomik duhet të deshmohet se ka të punësuar punonjësit me kualifikime teknike nga IQT në specialitetet si më poshtë: 2 punonjës elektrikist ; 2 punonjës mekanike; 2 punonjës saldator i patentuar Si dhe 3 punonjës instalator termo teknik të certifikuar”. Oferta përmban 2 punonjës të specializuar nga 3 që kërkohen në DST”

II.5. Në datën 04.04.2016 operatori ekonomik ankimues “Sulollari” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

1. Së pari: Ne kemi paraqitur kontratë të ngjashme më objekt (Riparim-mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja; stacionit qendror të pompave të ujit të pijshëm dhe elektropompave të godinave të shërbimeve spitalore dhe mjete të MNZH), me një vlerë prej 1 970 000 lekë pa tvsh, kontratë kjo e lidhur në datën 25.07.2014 më nr.prot.1766/18 me QUST.
Ndërkohë që vlera e kërkuar nga AK ishte 40 % e fondit limit brenda 3 viteve të fundit. Me kontratën e ngjashme të paraqitur ne jemi brenda rregulalve dhe kërkesave tuaja si AK.
2. Së dyti: Në lidhje me pikën ç) të kapacitetit teknik “ ç) Operatori ekonomik duhet të deshmohet se ka të punësuar punonjësit me kualifikime teknike nga IQT në specialitetet si më poshtë: 2 punonjës elektrikist ; 2 punonjës mekanike; 2 punonjës saldator i patentuar Si dhe 3 punonjës instalator termo teknik të certifikuar”. Kemi marrë pjesë në tender si bashkim operatorësh ekonomikë ku disa specialistë i ka firma “Sulollari” sh.p.k dhe disa i ka firma “Ershen” shpk. Që të dy operatorët së bashku plotësojnë numrin e specialistëve të kërkuar prej AK. Konkretisht 2 specialistë i ka firma “Sulollari” sh.p.k që janë instalatorë termoteknik të certifikuar, dhe 2 punonjës si ka firma “Ershen” shpk, të lëshuara nga IQT-inspektoriat i enëve nën presion për shfrytëzimin e kaldajave me ujë të nxehtë , sepse në kohën që janë marrë këto licenca ky ishte emërtimi për pasjisjet e enëve nën presion. Për më tepër mund të shikoni linkun e IQT-së, shërbimet që ofron Drejtoria e Inspektimit të Enëve nën Presion (DIPNP).

II.6. Në datën 08.04.2016 me anë të shkresën nr.1937/1 autoriteti kontraktor e ka venë në dijeni ankimuesin në lidhje me pretendimet e parashtuara në ankesë ku ka vendosur si më poshtë:

- *Pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me arsyen e parë të skualifikimit “Sherbime të ngjashme”.*
- *Mospranimin e ankesës lidhur me motivin e dytë të skualifikimit*

II.7. Në datën 18.04.2016 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me pretendimet si më poshtë:

1. *Në lidhje me pikën ç) të kapacitetit teknik “ ç) Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te punesuar punonjesit me kualifikime teknike nga IQT ne specialitetet si me poshte:2 punonjes elektrikist ; 2 punonjes mekanike; 2 punonjes saldator i patentuar Si dhe 3 punonjes instalator termo teknik te certifikuar”. Kemi marrë pjesë në tender si bashkim operatorësh ekonomikë ku disa specialistë i ka firma “Sulollari” sh.p.k dhe disa i ka firma “Erxhen” shpk. Që të dy operatorët së bashku plotësojnë numrin e specilastëve të kërkuar prej AK. Konkretisht 2 specialistë i ka firma “Sulollari” sh.p.k që janë instalorë termoteknik të çertifikuar, dhe 2 punonjë si ka firma “Erxhen” shpk, të lëshuara nga IQT-inspektoriati i enëve nën presion për shfrytëzimin e kaldajave me ujë të nxehtë , sepse në kohën që janë marrë këto liçenca ky ishte emërtimi për pasjjsjet e enëve nën presion. Për më tepër mund të shikoni linkun e IQT-së, shërbimet që ofron Drejtorja e Inspektimit të Enëve nën Presion (DIPNP).*

II.8. Në datën 27.04.2016 , është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sulollari” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k dhe “Erxhen” shpk lidhur me pikën ç) të kapacitetit teknik “ ç) Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te punesuar punonjesit me kualifikime teknike nga IQT ne specialitetet si me poshte:2 punonjes elektrikist ; 2 punonjes mekanike; 2 punonjes saldator i patentuar Si dhe 3 punonjes instalator termo teknik te certifikuar”.Oferta përmban 2 punonjës të specializuar nga 3 që kërkohen në DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Operatorët ekonomikë ankimes “Sulollari” sh.p.k dhe “Erxhen” sh.p.k kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur para një noteri publik me Nr.897 Rep dhe Nr.413 Kol datë 08.03.2016. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se referuar “Objektit” të kontratës, rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar mbi zbatimin e objektit “LOTI 3: *“Riparim-mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja; stacionit qëndror të pompave të ujit të pijshë m dhe elektropompave të godianve të shërbimeve spitalore”*”.

Shoqëritë “Sulollari” sh.p.k, dhe “Erxhen” sh.p.k bien dakord që të bashkojnë forcat dhe kompetencat e tyre në kuadrin e një bashkëpunimi të përkohshëm në një grup të vetëm (referuar më poshtë si “grupi”). Në pikën 7 të marrëveshjes së mësipërme parashikohet se “*Shoqëria Sulollari sh.p.k merr përsipër 40% të ofrimit të shërbimit ndërsa Erxhen sh.p.k merr përsipër 60% të ofrimit të shërbimit”*. *Ofrimi i shërbimit konkret për secilin anëtar të bashkimit do të jetë: Shoqëria Sulollari shpk do të përballojë financimin në masën e përqindjes së dhënë, mjeteve , pikave të licencës dhe të inxhinierëve, punonjësve për kryerjen e punimeve në bazë të preventivit dhe volumit të punës , kontratat e ngjashme, punonjësit e kualifikuar me IQT, ISO e kërkuar nga AK. Shoqëria Erxhen sh.p.k do të përballojë financimin deri në masën e përqindjes së dhënë , do të vëvrë në dispozicion fuqinë puntore në masën e përqindjes së marrë përsipër dhe pikave të licencës.*

III.1.2. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.3. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi përcaktohet se.

ç) *Operatori ekonomik duhet të deshmojë se ka të punësuar punonjësit me kualifikime teknike nga IQT në specialitetet si më poshtë:*

- 2 punonjes elektrikist
- 2 punonjes mekanikë
- 2 punonjes saldator i patentuar
- Si dhe 3 punonjes instalator termo teknik te certifikuar

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E) Komisioni konstatoi se në përmbushje të kriterit sa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k & “Erxfan” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

OE “Sulollari” sh.p.k

- Dëshmi kualifikimi Nr.008941 datë 26.03.2015 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik për punonjësën E.Z; Profesionin Teknik Kondicioner/Elektricit/Saldator/Hidraulik
- Dëshmi kualifikimi Nr.001691 datë 23.02.2016 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik për punonjësën E.K; Profesionin Elektricit.
- Dëshmi kualifikimi Nr.001688 datë 23.02.2016 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik për punonjësën L.SH Profesionin Mekanik
- Dëshmi kualifikimi Nr.001690 datë 23.02.2016 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik për punonjësën J.Gj Profesionin Saldator
- Leje për Përdorimin e Pajisjeve nën Presion Nr.74 lëshuar më datë 08.04.2015 lëshuar nga Inspektorati Qëndror teknik për punonjësën T.Z. (ka marrë formimin e mjaftueshëm për përdorimin dhe rreziqet që sjell përdorimi i pajisjeve nën presion për Inst,Shfrytëz, e Riparim të Sistemit Termo Teknike të PNP.
- Leje për Përdorimin e Pajisjeve nën Presion Nr.73 lëshuar më datë 08.04.2015 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik për punonjësën A.K. (ka marrë formimin e mjaftueshëm për përdorimin dhe rreziqet që sjell përdorimi i pajisjeve nën presion për Inst,Shfrytëz, e Riparim të Sistemit Termo Teknike të PNP.

OE “Erxfan” sh.p.k

- Dëshmi kualifikimi Nr.002132 datë 10.03.2016 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik për punonjësën SH.C; Profesionin Elektricit/Mekanik.
- Dëshmi kualifikimi Nr.002131 datë 10.03.2016 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik për punonjësën G.I; Profesionin Mekanik.
- Dëshmi kualifikimi Nr.002130 datë 10.03.2016 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik për punonjësën S.Q; Profesionin Elektricit/Mekanik.
- Leje për Shfrytëzimin e Kaldajave të Ujit të nxehtë Nr.465 lëshuar më datë 25.07.2007 lëshuar nga Inspektorati i Pajisjeve nën Presion për punonjësën L.P.
- Patentë Nr. 1094 për Shfrytëzimin e Kaldajave të Ujit të nxehtë si kaldaist dhe elektrikist lëshuar më datë 07.02.2012 lëshuar nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion për punonjësën S.A. (Shënim Kjo leje është e vlefshme për një kohë deri në pesë vjet)

III.1.5. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e

mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.6. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“[...]aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”*. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit disponon në stafin e tij punonjës të kualifikuar sipas speciliteteve të ndryshme, në përputhje me nenin 74, pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se në tërësi dhe veçmas bashkimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor në drejtim të stafit teknik, punonjës të kualifikuar sipas specialiteteve të ndryshme.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k& “Erxhen” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Proçedurë e hapur”, me numër REF-24353-02-17-2016 me objekt Loti III "Riparim-mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja; stacionit qëndror të pompave të ujit të pijshëm dhe elektropompave të godinave të shërbimeve spitalore", me fond limit 2.298.375 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 11.03.2016, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nëne Tereza”, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anullopjë vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k& “Erxhen” sh.p.k duke i kualifikuar ata.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Sulollari” sh.p.k
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 950 Protokoli, Datë 18.04.2016

Public Health Sector
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Mendim Kundër

Unë, anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik (në vijim KPP), Juliana Hoxha nuk jam dakord me dispozitivin e vendimit, si edhe me pjesën e arsytimit të tij për sa i përket ankesës me objekt: Kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k& “Erxhen” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me numër REF-24353-02-17-2016 me objekt *Loti III "Riparim-mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe të ujit sanitar me kaldaja; stacionit qëndror të pompave të ujit të pijshëm dhe elektropompave të godianve të shërbimeve spitalore"*, me fond limit 2.298.375 lekë pa tvsh, zhvilluar në datë 11.03.2016, nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nëne Tereza”, Tiranë.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I. Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k& “Erxhen” sh.p.k me argumentin se: *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k dhe “Erxhen” shpk lidhur me pikën ç) të kapacitetit teknik “ ç) Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te punesuar punonjesit me kualifikime teknike nga IQT ne specialitetet si me poshte: 2 punonjes elektrikist ; 2 punonjes mekanike; 2 punonjes saldator i patentuar Si dhe 3 punonjes instalator termo teknik te certifikuar”.Oferta përmban 2 punonjës të specializuar nga 3 që kërkohen në DST, vërej se:*

III.1.1. Operatorët ekonomikë ankimues “Sulollari” sh.p.k dhe “Erxhen” sh.p.k kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit lidhur para një noteri publik me Nr.897 Rep dhe Nr.413 Kol datë 08.03.2016. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se referuar “Objektit” të kontratës, rezulton se bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar mbi zbatimin e objektit “Loti VII “*“Riparim-Mirëmbajtje në sisteme ngrohje-ftohje me chiller për sallat operatore dhe reanimatore të shërbimeve mjekësore: Urologji, Pediatri, Kardiokirurgji, Kardiologji, Dializa, Spitali Francez, Spitali Infektiv, Onkologjik, Djegie Plastika dhe të kondicionerëve, si dhe në godinat spitalore: Psikiatri, Pediatri, Neurologji, Neurokirurgji”*.

Shoqëritë “Sulollari” sh.p.k, dhe “Erxhen” sh.p.k bien dakord që të bashkojnë forcat dhe kompetencat e tyre në kuadrin e një bashkëpunimi të përkohshëm në një grup të vetëm (referuar më poshtë si “grupi”). Në pikën 7 të marrëveshjes së mësipërme parashikohet se “*Shoqëria Sulollari sh.p.k merr përsipër 40% të ofrimit të shërbimit ndërsa Erxhen sh.p.k merr përsipër*

60% të ofrimit të shërbimit”. Ofrimi i shërbimit konkret për secilin anëtar të bashkimit do të jetë: Shoqëria Sulollari shpk do të përballojë financimin në masën e përqindjes së dhënë, mjeteve , pikave të licencës dhe të inxhinierëve, punonjësve për kryerjen e punimeve në bazë të preventivit dhe volumit të punës , kontratat e ngjashme, punonjësit e kualifikuar me IQT, ISO e kërkuar nga AK. Shoqëria Erxhen sh.p.k do të përballojë financimin deri në masën e përqindjes së dhënë , do të vëvrë në dispozicion fuqinë puntore në masën e përqindjes së marrë përsipër dhe pikave të licencës.

III.1.2. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.3. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi përcaktohet se.

ç) Operatori ekonomik duhet të deshmojë se ka të punësuar punonjësit me kualifikime teknike nga IQT në specialitetet si më poshtë:

- 2 punonjës elektrikist
- 2 punonjës mekanikë
- 2 punonjës saldator i patentuar
- Si dhe 3 punonjës instalator termo teknik të certifikuar

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E) konstatoj se në përmbushje të kriterit sa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sulollari” sh.p.k & “Erxhen” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

OE “Sulollari” sh.p.k

- Dëshmi kualifikimi Nr.008941 datë 26.03.2015 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik për punonjës të E.Z; Profesionit Teknik Kondicioner/Elektricit/Saldator/Hidraulik
- Dëshmi kualifikimi Nr.001691 datë 23.02.2016 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik për punonjës të E.K; Profesionit Elektricit.
- Dëshmi kualifikimi Nr.001688 datë 23.02.2016 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik për punonjës të L.SH Profesionit Mekanik
- Dëshmi kualifikimi Nr.001690 datë 23.02.2016 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik për punonjës të J.Gj Profesionit Saldator
- Leje për Përdorimin e Pajisjeve nën Presion Nr.74 lëshuar më datë 08.04.2015 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror teknik për punonjës të T.Z. (ka marrë formimin e mjaftueshëm për përdorimin dhe rreziqet që sjell përdorimi i pajisjeve nën presion për Inst,Shfrytëz, e Riparim të Sistemit Termo Teknike të PNP.
- Leje për Përdorimin e Pajisjeve nën Presion Nr.73 lëshuar më datë 08.04.2015 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik për punonjës të A.K. (ka marrë formimin e mjaftueshëm për përdorimin dhe rreziqet që sjell përdorimi i pajisjeve nën presion për Inst,Shfrytëz, e Riparim të Sistemit Termo Teknike të PNP.

OE "Ershen" sh.p.k

- Dëshmi kualifikimi Nr.002132 datë 10.03.2016 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik për punonjës të SH.C; Profesionit Elektricit/Mekanik.
- Dëshmi kualifikimi Nr.002131 datë 10.03.2016 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik për punonjës të G.I; Profesionit Mekanik.
- Dëshmi kualifikimi Nr.002130 datë 10.03.2016 lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik për punonjës të S.Q; Profesionit Elektricit/Mekanik.
- Leje për Shfrytëzimin e Kaldajave të Ujit të nxehtë Nr.465 lëshuar më datë 25.07.2007 lëshuar nga Inspektoriati i Pajisjeve nën Presion për punonjës të L.P.
- Patentë Nr. 1094 për Shfrytëzimin e Kaldajave të Ujit të nxehtë si kaldaist dhe elektricit lëshuar më datë 07.02.2012 lëshuar nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion për punonjës të S.A. (Shënim Kjo leje është e vlefshme për një kohë deri në pesë vjet)

I.1.5.Pas shqyrtimit të parashtrimeve me shkrim të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues si dhe pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatoj se në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit në drejtim të disponueshmërisë së 3 punonjësve instalatorë termo teknik të pajisur me IQT operatorët ekonomikë kanë dorëzuar certifikata të lëshuar nga Inspektoriati Qëndror Teknik nga ku nuk bëhet lidhja midis punonjësve të certifikuar dhe vetë operatorit ekonomik i cili pretendon se në stafin e tij disponon punonjës të certifikuar sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.Kjo do të thotë se bashkimi i operatorëve Sulollari sh.p.k dhe Ershen sh.p.k nuk arrijnë të provojnë faktin se këto punonjës janë pjesë e stafit të shoqërive respektive e rrjedhimisht përmbushjen e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Gjithashtu nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatoj se secili nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "Sulollari" sh.p.k& "Ershen" sh.p.k kanë paraqitur Listpagesat e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për periudhën e kërkuar në

dokumentat e tenderit *Janar-Dhjetor 2015*. Nga verifikimi i tyre rezulton se punonjësi me inicialet A.K për të cilin anëtarë i bashkimit të përkohëshëm Sulollari shpk ka paraqitur Leje për Përdorimin e Pajisjeve nën Presion Nr.73 lëshuar më datë 08.04.2015 lëshuar nga Inspektorati Qëndror Teknik në përmbushje të kriterit sa më sipër nuk rezulton të jetë i deklaruar në listpagesa gjithashtu konstatoj të njëjtën mangësi për punonjësin me inicialet L.P për të cilin anëtarë tjetër i bashkimit Erxhen sh.p.k ka paraqitur Leje për Shfrytëzimin e Kaldajave të Ujit të nxehtë Nr.465 lëshuar më datë 25.07.2007 i cili nuk rezulton të jetë i deklaruar në listpagesat e këtij të fundit.

III.1.6. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III.1.7. Gjykoj se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]*”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

I.1.8. Sa më sipër gjykoj se bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ka aritur të provojë me anë të dokumentacionit konkret disponueshmërinë lidhur me 3 insalatorë termo teknik të certifikuar pasi duke mos qenë të deklaruar në listpagesë nuk vërtetohet lidhja konkrete që kanë punonjësit e sipërcituar me secilin nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim gjykoj se në tërsi dhe vecmas bashkimi i operatorëve ekonomikë është në kushtet e mospërmbushjes së kriterit lidhur me disponimin e tre punonjësve insalatorë termo tekniktë kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

I.1.9. Vlerësoj se Komisioni i Prokurimit Publik si organi më i lartë në fushën e prokurimeve publike (*neni 19/2 i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar*), është garant i kontrollit të ligjëshmerisë dhe vlerësimit objektiv të ofertave nga ana e autoriteteve kontraktore (institucioneve dhe enteve publike që realizojnë procedurat e prokurimit) duke shmangur vlersimet subjektive dhe jo të lidhura me dokumentacionin e depozituar nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokuruese.

Anëtare
Juliana Hoxha

